



**AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË**

Tiranë, më 07.01.2026 nr. 30 prot.



**KOLEGJI PROFESIONAL
GJERMAN I TEKNOLOGJISE**

Tiranë, më 07.01.2026 nr. 6 prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (ASHSH) DHE KOLEGJIT PROFESIONAL GJERMAN TE TEKNOLOGJISE (KPGJT)

Nisur nga vullneti i mirë për bashkëpunim të dyanshëm në kërkimin shkencor e në formimin universitar të brezave të rinj në fushën e teknologjise se automobilit, elektromekanikes, elektronikes, teknologjise se informacionit, mekatronikes, teknologjisë së ngrohje ftohjes dhe ajrit të kondicionuar, menaxhimit te hoteleri turizmit, administrimit të ndërtimit etj.

Në përputhje me strategjinë e hapjes ndaj bashkësive shkencore-universitare që ndiqet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej ASHSH) dhe me politikat bashkëpunuese të Kolegjit Profesional Gjerman te Teknologjise (më tej KPGJT);

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), me qendër në Tiranë, sheshi *Fan Noli*, e përfaqësuar nga Sekretarja Shkencore akad. Anila Hoda dhe Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë (KPGJT), përfaqësuar nga rektori akad. Jorgaq Kaçani, më tej të quajtura *Palë*, nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi

Neni 1 Objekti dhe qëllimi

Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëpunimin ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë, me qëllim rregullimin e bashkëpunimit ndërinstitucional midis *Palëve*, si dhe midis strukturave përbërëse të tyre; përcaktimin e prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi e në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkëta.

Neni 2

Parime bazë

1. Parim themelor rregullues për bashkëpunimin e *Palëve* është autonomia akademike dhe universitare. Ato bashkëpunojnë duke respektuar njëra tjetrën në vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligje dhe me akte nën ligjore duke ruajtur dhe zhvilluar traditat më të suksesshme, përmes nismash, projektsh dhe veprimtarish të përbashkëta akademike e universitare.
2. Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre *Palët* pranojnë dhe respektojnë kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagiaturës dhe pseudoshkencës.

Neni 3

Drejtimet kryesore të bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi midis *Palëve* shtrihet në gjithë fushat e dijes, me përparësi shkencat me më shumë interes të përbashkët, si inxhinieria, ekonomia dhe turizmi, etj.
2. *Palët* bashkëpunojnë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, si: kuvende, kongrese, konferenca, forume, simpoziume etj.
3. *Palët* inkurajojnë kontaktet dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis strukturave përbërëse të tyre: departamenteve (në KPGJT) dhe komisioneve të përhershme, posaçërisht të komisionit të inxhinierise, si dhe të komisionit të ekonomisë (pranë ASHSH).
4. *Palët* bashkëpunojnë për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore vendore, rajonale dhe europiane.
5. *Palët* bashkëpunojnë për nxitjen dhe promovimin e studiuesve të rinj.
6. *Palët* bashkëpunojnë për hartimin e strategjive të zhvillimit dhe të akteve normative në zbatim të tyre.

Neni 4

Bashkëpunime të veçanta

Përtej drejtimeve kryesore të bashkëpunimit, *palët* realizojnë dhe bashkëpunime të veçanta të cilat shtrihen kryesisht në:

1. Shkëmbimin e programeve vjetore të veprimtarisë shkencore, gjegjësisht të mësimdhënies universitare, për të lehtësuar pjesëmarrjen e kërkuesve të dy institucioneve në aktivitetet me interes për njëra-tjetrën;
2. Mbështetje reciproke për aplikime në projektet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit (PKZH, PIKZH, administruar nga AKKSHI); aplikime të përbashkëta për projekte lokale në fushën e teknologjise se automobilit, elektromekanikes, elektronikës, teknologjise se informacionit, mekatronikes, teknologjisë së ngrohje ftohjes dhe ajrit të kondicionuar, menaxhimit hotelier turizmit, administrimit të ndertimit;
3. Pjesëmarrje e profesoratis të KPGJT si kontribuues në veprimtaritë e ASHSH, gjegjësisht e specialistëve prej trupës akademike të ASHSH në mësimdhënie universitare për programe të studimeve;
4. Organizojnë së paku një veprimtari të përbashkët shkencore në vit (seminar, ëorkshop), duke përfshirë ligjërata akademike dhe universitare (edhe nëpërmjet platformave të mësimin në distancë);
5. Munësojnë pjesëmarrjen e profesoratis dhe studentëve të KPGJT në veprimtaritë që organizon ASHSH në kuadër të politikës *Shkenca dhe edukimi*;

Neni 5

Protokollet e bashkëpunimit

Për rregullimin e marrdhënieve specifike juridike – financiare që mund të lindin në vijim, sipas rëndësisë dhe rast pas rasti, palët nënshkruajnë protokolle të përsoshme bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes Palëve.

Neni 6

Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

1. Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjellë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor (katalogë, udhërrëfyes, bibliografi), të periodikëve që botojnë, të botimeve të digjitalizuara, të studimeve dhe monografive, etj.
2. Palët shkëmbejnë falas përmes procedurës së dhurimeve, botimet shkencore në përputhje me profilin dhe nevojat e bibliotekave të dy institucioneve.
3. ASHSH mundëson gjithashtu pajisjen me kartë digjitale të profesorit të KPGJT për kërkim të lirë në bazat e të dhënave të administruara prej saj si *Cobiss.al* dhe *Ecris.al*, duke vendosur lidhje të drejtpërdrejta bashkëpunimi me *qendrën kombëtare për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor* që funksionon pranë saj.
4. Pika kontakti për komunikimin e vazhdueshëm në kuadër të realizimit të objektivave të kësaj marrëveshje do të jenë:
 - Për Akademinë e Shkencave: akad. Neki Frashëri, me detyrë kryetar i seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike, me adresë e-maili: neki.frasheri@akad.gov.al dhe nr. telefoni: 0682259467;
 - Për Kolegjin Profesional Gjerman të Teknologjisë: z Adjon Dollakaj, me detyrë pedagog, me adresë e-maili: adjon.dollakaj@mercedes-benz.al dhe nr. telefoni: 0699770401.
5. Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të ndërsjellë.

Neni 7

Zbatimi i marrëveshjes dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje ka fuqi veprimi për një afat kohor për 4 (katër) vjet. Me mbarimin e këtij afati ajo mund të përsëritet edhe për dy vjet të tjera, përveç rastit kur njëra nga Palët njofton me shkrim mungesën e interesit jo më vonë se gjashtë muaj para mbarimit të afatit të vlefshmërisë.
2. Palët takohen dy herë në vit për të vlerësuar ecurinë e Marrëveshjes.
3. Ndërprerja e saj pranohej prej Palëve në rastet kur:
 - Ndryshon statusi ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër;
 - Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazë të saj në procesin e plotësimit të kushteve të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 8
Të tjera

Kjo marrëveshje nuk parashikon detyrime financiare për *Palët*. Ndarja e përgjegjësisë në buxhet për veprimtaritë e përbashkëta bëhet rast pas rasti;

Palët favorizojnë përfshirjen e njëra-tjetrës në bashkëpunime të tjera dypalëshe, në përputhje me përparësitë që caktohen në këtë marrëveshje;

Neni 9
Të fundme

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën palë, me vlerë të barabartë.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga përfaqësuesit e autorizuar të dy *Palëve*.

Për:

**AKADEMINË E SHKENCAVE
TË SHQIPËRISË**

Akad. Anila Hoda

SEKRETARE SHKENCORE



**PËR KOLEGJIN PROFESIONAL
GJERMAN TE TEKNOLOGJISE**

Akad. Jorgaq Kaçani

REKTOR